MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I FERMËS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i qëndrueshëm i fermës
Programi:	Menaxhim ne Agrobiznes
Niveli:	Master (MSc)
Statusi lëndës:	Obligative (O)
Viti i studimeve:	Viti 1 / Semestri 2
Numri i orëve në javë:	3 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	7 ECTS
Koha / lokacioni:	Do të shpallet
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Sadik Maloku
Të dhënat kontaktuese:	sadik.maloku@uni-prizren.com; +383 49 338 339
Përshkrimi i lëndës:	Ky kurs është i ndërtuar t'ju vijë në ndihmë dhe t'i shërbejë studentëve përmes trajtime të rëndësishme teorike në fushën e menaxhimit të qëndrueshëm të fermave. Drejtimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë janë faktorë të rëndësishëm në suksesin e një biznesi (përfshirë edhe fermën bujqësore). Në këtë kontekst duhet theksuar se përgatitja dhe zhvillimi i këtij kursi do t'u shërbejë jo vetëm studentëve që janë të interesuar për zhvillimin e bizneseve në bujqësi. Ana metodike dhe praktike e problemeve të drejtimit në këtë kurs është gërshëtuar me realitetin e fermave bujqësore në Kosove dhe rajon. Temat e trajtuara në këtë lëndë përfshijnë: zhvillimin e qëndrueshëm të sistemeve të prodhimit bujqësor, faktorët ambiental dhe ekonomik që ndikojnë në rajonizimin e prodhimit dhe zgjedhjen e aktiviteteve në fermë, madhësia e fermës bujqësore dhe rritja e saj, menaxhimi i fermës në kushtet e riskut dhe pasigurisë, analiza e investimeve, sigurimi dhe përdorimi i kapitalit dhe kreditit, sigurimi dhe përdorimi i tokës, sigurimi dhe përdorimi i i krahut të punës, sigurimi dhe përdorimi i makinerive bujqësore. Pjesa më e madhe e kohës së leksioneve do t'i kushtohet diskutimit të zgjidhjes së problemeve të menaxhimit të fermave duke zbatuar parimet ekonomike të drejtimit.
Qëllimi i lëndës:	Qëllimi i këtij kursi është t'i mësoj studentët të identifikojnë dhe të njohin elementët dhe faktorët që përcaktojnë sistemet e prodhimit bujqësor; të njohin konceptin e qëndrueshmerisë së sistemeve bujqësore dhe të dallojnë qëndrueshmërinë e sistemeve të prodhimit në vendet e zhvilluara dhe në vendet në zhvillim; të njohin faktorët ambiental dhe ekonomik që ndikojnë në rajonizimin e prodhimit dhe zgjedhjen e aktiviteteve në fermë; të kuptojë lidhjet e madhësisë së fermës bujqësore me koston; procesin, domosdoshmërinë, kushtet e rritjes dhe menyrat e financimit të madhësisë së fermës bujqësore; të njohin burimet e rriskut në bujqësi dhe strategjitë që kontrollojnë dhe reduktojnë riskun; të kuptojë ekonominë e përdorimit të kapitalit si dhe burimet e sigurimit të tij; të njihen me karakteristikat e tokës bujqësore dhe planifikimin e përdorimit të saj; të kuptojnë ekonominë e përdorimit të krahut të punës në fermë, matjen dhe përmirësimin e efektivitetit të punës në fermë; të kuptojë dhe të përcaktojë kostot e makinerive dhe të njoh burimet e sigurimit të tyre në fermë.

Rezultatet e të nxënit:	Pas përfundimit të suksesshëm të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të: ▪ Kuptojnë dhe të përdorin terminologjinë dhe konceptet kryesore të menaxhimit të qëndrueshëm të fermave. ▪ Vlerësojnë elementet dhe faktoret kyq qe percaktojne sistemet e prodhimit bujqesor. ▪ Përdorin konceptin e qëndrueshmërisë së sistemeve bujqësore. ▪ Diskutojnë faktorët ambiental dhe ekonomik që ndikojnë në rajonizimin e prodhimit. ▪ Vlerësojnë dhe diskutojnë lidhjet e madhësisë së fermës bujqësore me koston ▪ Vlerësojnë procesin, domosdoshmërinë, kushtet e rritjes dhe menyrat e financimit të madhësisë së fermës bujqësore ▪ Analizojnë burimet e riskut në bujqësi dhe të tregojnë aftësi për të identifkuar strategjitë që kontrollojnë dhe reduktojnë riskun. ▪ Analizojnë ekonominë e përdorimit të kapitalit si dhe burimet e sigurimit të tij. ▪ Vlerësojnë karakteristikat e tokës bujqësore dhe planifikimin e përdorimit të saj. ▪ Diskutojnë ekonominë e përdorimit të krahut të punës në fermë, matjen dhe përmirësimin e efektivitetit të punës në fermë. ▪ Përcaktojë kostot e makinerive dhe të njoh burimet e sigurimit të tyre në fermë.

Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithsej**
Ligjërata	3	15	45
Ushtrimeteorike/laboratorike	2	15	30
Punëpraktike	3	3	9
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	12	12
Ushtrime në terren	3	4	12
Kollokfiume, seminare	3	1	3
Detyratë e shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	2	13	26
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	3	1	3
Projektet, prezantimet ,etj	5	1	5
Totali			**175 orë (7 ECTS)**

Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, diskutime, konsultime, projekte kursi, detyra shtëpie, kollokviume, provime.
Metodologjia e vlerësimit:	Vijueshmëria e rregullt dhe aktive: 10%, Provimi i ndërmjetëm (kollokviumi): 20%, Projekti i kursit: 10%, Provimi final: 60%,
Literatura	
Literatura primare:	Meço, M., Mehmeti, G., Murrja, A., Tomorri, I., Maloku, S. (2017). Drejtimi i Fermave. Dita 2000, Tiranë.
Literatura shtesë:	Ronald D. Kay, William M. Edwards, and Patricia A. Duffy, Farm Management, 6th Edition, by McGraw-Hill, 2009. Raanan Weitz, from peasant to farmer: a revolutionary strategy for development, Columbia University Press, New York and London, 1971. M. D. Boehlje, V. R. Eidman, Farm Management, by John Wiley and Sons Inc. 1984. C. S. Barnard, J. S. Nix, Farm Planning and Control, Cambridge University Press. Raymond R. Beneke, Managing the Farm Business, John Wiely and Sons, Inc.

Plani i dizajnuar i mësimit:		
Java	**Ligjërata**	**Ushtrime**
Java e parë:	Zhvillimi i qëndrueshëm i sistemeve të prodhimit bujqësor (Elementet dhe faktorët që përcaktojnë sistemet e prodhimit bujqësor, Sistemet e prodhimit bujqësor në Shqipëri dhe rajon)	Shpërndarja e temave të projekteve seminarike.
Java e dytë:	Zhvillimi i qëndrueshëm i sistemeve të prodhimit bujqësor (Elementet dhe faktorët që përcaktojnë sistemet e prodhimit bujqësor, Sistemet e prodhimit bujqësor në Shqipëri dhe rajon)	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës parë të ligjëratave.
Java e tretë:	Qëndrueshmeria e sistemeve bujqësore (Qëndrueshmëria e sistemeve të prodhimit në vendet e zhvilluara dhe në vendet në zhvillim)	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës dytë të ligjëratave.
Java e katërt:	Faktorët ambiental dhe ekonomik që ndikojnë në rajonizimin e prodhimit dhe zgjedhjen e aktiviteteve në fermë (Faktorët ambjental, Faktorët ekonomik,	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës tretë të ligjëratave.

	Zgjedhja e aktiviteteve dhe kombinimi i tyre, Diversifikimi i moderuar, Përdorimi i programimit të thjeshtë dhe progamimit linear në optimizimin (diversifikimin) e strukturës së prodhimit, Llojet e aktiviteteve bujqësore, Faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e kombinimit të aktiviteteve bujqësore në fermë, Diversifikimi vertikal)	
Java e pestë:	Faktorët ambiental dhe ekonomik që ndikojnë në rajonizimin e prodhimit dhe zgjedhjen e aktiviteteve në fermë (Faktorët ambjental, Faktorët ekonomik, Zgjedhja e aktiviteteve dhe kombinimi i tyre, Diversifikimi i moderuar, Përdorimi i programimit të thjeshtë dhe progamimit linear në optimizimin (diversifikimin) e strukturës së prodhimit, Llojet e aktiviteteve bujqësore, Faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e kombinimit të aktiviteteve bujqësore në fermë, Diversifikimi vertikal)	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës katërt të ligjëratave.
Java e gjashtë:	Madhësia e fermës bujqësore dhe rritja e saj (Lidhjet e madhësisë së fermës bujqësore me koston, Procesi i rritjes së madhësisë së fermës bujqësore, Planifikimi i rritjes së madhësisë së fermës bujqësore, Faktorët që nxisin ose ngadalësojnë rritjen në perspektivë të madhësisë së fermës bujqësore)	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës pestë të ligjëratave.
Java e shtatë:	Madhësia e fermës bujqësore dhe rritja e saj (Lidhjet e madhësisë së fermës bujqësore me koston, Procesi i rritjes së madhësisë së fermës bujqësore, Planifikimi i rritjes së madhësisë së fermës bujqësore, Faktorët që nxisin ose ngadalësojnë rritjen në perspektivë të madhësisë së fermës bujqësore)	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës gjashtë të ligjëratave.
Java e tetë:	Provimi i ndërmjetëm	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës shtatë të ligjëratave.
Java e nëntë:	Drejtimi i fermës në kushtet e riskut dhe pasigurisë (Burimet e riskut në bujqësi dhe qëndrimet e fermerëve ndaj tij, Strategjitë që kontrollojnë dhe reduktojnë riskun në	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës tetë të ligjëratave.

	bujqësi)	
Java e dhjetë:	Analiza e investimeve (Vlera në kohë e parave, Analiza e investimeve, Faktorë të tjerë që ndikojnë në analizën e investimeve)	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës nëntë të ligjëratave.
Java e njëmbëdhjetë:	Sigurimi dhe përdorimi i kapitalit dhe kreditit (Ekonomia e përdorimit të kapitalit, Burimet e sigurimit të kapitalit, Llojet e kredive, Faktorët që ndikojnë në marrjen dhe dhënien e kredisë)	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës dhjetë të ligjëratave.
Java e dymbëdhjetë:	Sigurimi dhe përdorimi i i tokës (Karakteristikat e tokës, Planifikimi i përdorimit të tokës, Format e administrimit të tokës, Llojet e qirasë në bujqësi, Fragmentarizimi i tokës në fermë)	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës njëmbëdhjetë të ligjëratave.
Java e trembëdhjetë:	Sigurimi dhe përdorimi i krahut të punës (Burimet e krahut të punës në fermë, Ekonomia e përdorimit të krahut të punës në fermë, Matja e efektivitetit të punës në fermë, Përmirësimi i efektivitetit të punës, Drejtimi i krahut të punës të marrë me pagesë)	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës dymbëdhjetë të ligjëratave.
Java e katërmbëdhjetë:	Sigurimi dhe përdorimi i makinerive bujqësore (Përcaktimi i kostove të makinerive, Burimet e sigurimit të makinerive, Zëvëndësimi i punës së krahut me punën e makinerive, Zgjedhja e makinerive, Vendimet për zëvëndësimin e makinerive)	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës trembëdhjetë të ligjëratave.
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezantimi i projekteve semestrale.	Prezantimi dhe diskutimi i projekteve semestrale të studentëve.

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

- Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe Kodin e etikës.
- Studenti duhet të respektojë orarin e ligjeratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm.
- Studenti posedojë dhe paraqesë ID kartën në provime e ndërmjeme dhe provime përfundimtare,
- Gjatë hartimit të projekteve të kursit, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimet e dhëna nga mësimdhënësi.
- Gjatë orës së provimit është i ndaluar përdorimi i celularëve.